# AKT-THEMELIMI

# I

# SHOQERISE "XHENI A.D."SHPK

Sot,me dt 18.09.2001,une Arjana Demi e bija e Teki e dtl 1960 banuese ne Shoder ,L.Perlat Rexhepi ,rruga Bardhok Biba nr.9, ne mbeshtetje te ligjit nr.7512 date 10.8.1991 dhe ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 dhe lòigjit nr.7667 dt 28.01.1993, vendosa krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "XHENI A.D." me ortak te vetem,mua Arjana Demi.

NENI 2

Selia e shoqerise "XHENI A.D."shpk do te jete ne qytetin e Shkodres prane Sheshi "2 Prilli" Shkoder.

NENI 3

Kjo shoqeri do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e:

**-tregtimit me shumice e pakice te mallrave te ndryshem te import-eksportit,artikujve te ndryshem industrial,te konsumit te gjere,ushqimore,bujqesor e blegtoral, elektroshtepiake,makineri e paisje, materiale ndertimi ,eksport-importit,**
**-transport mallrash e pasagjeresh,**
**-te perfaqsimit te firmave te ndryshme te huaja, ndermjetesimit me te gjitha llojet per tregtine me jashte dhe pune komisionere ne fushen e tregtise,**
**-ne fushen e telekomunikacionit.**

NENI 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe eshte kontribut i ortakut te vetem te shoqerise,themelueses se saj Arjana Demi.
Per te saktesuar veprimtarine vet ekonomike si he mardheniet e punes, shoqeria do te cele e do te mbaje librin e vet qe quhet "libri i shoqerise".
Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "XHENI A.D." shpk Shkoder do te mbaje llogarine e saj duke u mbeshtetur tek leku shqiptar dhe valutat e huaja.

Mardhenit e punes ne shoqeri so te rregullohen nepermjet kontrates se punes.Per ceshtje qe nuk rregullohen nga kontrata e punes, shoqeria do te bazohet ne legjislacionin ne fuqi ,dhe vendimet e ortakut te vetem te saj.
E njejta gje vlen edhe per zyrat, filialet , deget e dyta ose agjensite.

NENI 5

Kohezgjatja e veprimatrise se shoqerise eshte mbi 10 vjet.Ajo mund te shperndahet me vendim te ortakut te vetem te shoqerise ose me vendim te personave te autorizuar prej tij me prokure te posacme per shperndarjen e shoqerise, ose kur shperndarjen e saj e percakton legjislacioni ne fuqi.

NENI 6

Shoqeria "XHENI A.D." SHPK Shkoder do te perfaqsohet nga ortaku i vetem i shoqerise Arjana Demi si dhe persona te tjere te autorizuar prej saj me prokure te posacme.

NENI 7

Ndryshimet ne kete akt-themelimi do te behen me te njejten procedure qe u ndjek per vete akt themelimin.
Akt-themelimi u nenshkrua rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "XHENI A.D" shpk Shkoder Zj.-Arjana Demi

ARJANA DEMI

Arjana Demi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE SHKODER

NR REP 1319
NR KOL 679

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me dt 22.09.2001 ne zyren e noterise Shkoder dhe para meje noteres Anila Dibra u paraqit personalisht Zj.Arjana Demi e bija e Teki e dtl 1960 banuese ne Shkoder ,per identitetin e te ciles u sigurova ne baze te dokumenteve te saj te identifikimit dhe pasi konstatova se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga ligji dhe me deshiren e saj te plote i vertetova nenshkrimin.

NOTERE ANILA DIBRA

# S T A T U T I

## I

## SHOQERISE "XHENI A.D."SHPK

Ne mbeshtetje te ligjit nr.7512 date 10.8.1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones tregtare e te privatizimit"dhe ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"dhe ligjit nr.7667 dt 28.01.1993, "Per regjistrimin e shoqerisve ne regjistrin tregtar" me vullnetin e lire te shprehur ne nenshkrimin e aktit te themelimit qe i bashkangjitet ketij statuti:

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "XHENI A.D." me ortak te vetem,mua Arjana Demi e bija e Teki e dtl 1960 banuese ne Shkoder L.Perlat Rexhepi Rr.Bardhok Biba nr.9.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "XHENI A.D" SHPK fiton zotesine per te vepruar nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregtar ne gjykaten e rrethit Tirane,ndersa ushtron aktivitetin e saj ekonomik me regjistrimin e saj ne organin tatimor te pushtetit.
Ajo eshte person juridik dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi, dhe te akteve te saj themeluese si ky statut dhe aktit te themelimit qe i bashkohet dhe perben nje pjese te pandare te saj.

SELIA

NENI 2

Selia e shoqerise "XHENI A.D."shpk do te jete ne qytetin e Shkodres prane Sheshi "2 Prilli" Shkoder.

Shoqeria mund te hape edhe vend-qendrime te tjera te dyta, operative, perfaqsi dhe agjensi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, me miratimin e organeve kompetente n perputhje me legjislacioin e vendit du ato hapen.

OBJEKTI

NENI 3

Kjo shoqeri do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e:

**-tregtimit me shumice e pakice te mallrave te ndryshem te import-eksportit,artikujve te ndryshem industrial,te konsumit te gjere,ushqimore , bujqesor e blegtoral, elektroshtepiake,makineri e paisje, materiale ndertimi , eksport-importit,**
**-transport mallrash e pasagjeresh,**
**-te perfaqsimit te firmave te ndryshme te huaja, ndermjetesimit me te gjitha llojet per tregtine me jashte dhe pune komisionere ne fushen e tregtise,**
**-ne fushen e telekomunikacionit.**

KOHE ZGJATJA

NENI 4

Kohezgjatja e veprimatrise se shoqerise eshte mbi 10 vjet.Ajo mund te shperndahet me vendim te ortakut te vetem te shoqerise ose me vendim te personave te autorizuar prej tij me prokure te posacme pr shperndarjen e shoqerise, ose kur shperndarjen e saj e percakton legjislacioni ne fuqi.

NENI 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "XHENI A.D." shpk Shkoder, mund te ndryshoje emertimin ,seline dhe objektin e veprimatrise se saj sipas vendimeve qe do te marre ortaku i vetem i shoqerise Zj.Arjana Demi.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise "XHENI A.D." shpk Shkoder eshte 100.000 leke ,e eshte kontribut i ortakut te vetem Zj.Arjana Demi.

Kapitali themeltar mund te shtohet me deshiren dhe sipas vendimebve te ortakut te vetem te shoqerise Zj.Arjana Demi.

Kapitali themeltar ose pjese te tij mund te transferohen ose te lihen peng ne perputhje me ligjet ne fuqi, duke u vertetuar me nje akt noterial.

Kapitali themeltar mund te transferohet ne rruge trashegimie.
Bashkshorti, paraardhesi, ose pasardhesit e e ortakut te vetem mund behen ortak te shoqerise nepermjet transferimit te te pjeseve te kapitalit themeltar.
Pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise mund te transferohen te treteve qe nuk bejne pjese si ortake te shoqerise vetem me miratimin e ortakut te vetem te shoqerise Zj.Arana Demi.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

### NENI 7

Shoqeria "XHENI A.D" shpk Shkoder eshte prone e themelueses se saj ,ortakut te vetem Zj.Arjana Demi , e cila eshte edhe organi vedimor i shoqerise, dhe ka te drejten e zgjedhjes se administratoreve qe do te hyjne ne mardhenje me te tretet.

Ortak i vetem i shoqrise therret mbledhjet e zakonshme dhe te jashtzakonshme te shoqerise.
Ne mbledhjet e zakonshme ai shqyrton e vendos per ceshtje te tilla si emerim e shkarkim te personave te punesuar ne kete shoqeri dhe analizen e gjithe aktivitetit te shoqerise si dhe ndarjen e fitimit.
Ne mbledhjet e jashtzakonshme ai shqyrton dhe vendos per ceshtje te tilla si :ndryshim statuti, zvoglelim ose zmadhim te kapitalit themeltar,zgjatje ose zvogelim te kohes se veprimatrise ose likujdimin e shoqerise.

### NENI 8

Ne emer te shqrie administratori ka keto kompetenca:

-Te marre pjes ne ankande,te prpiloje konrata te cdo lloji qofshin ato dhe akte te tjera juridike qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise,te hape llogari rrjedhese bankare ne Banken Shqiptare brenda dhe jashte vendit,ta perfaqsoje shoqerine ne te gjitha strukturat shteterore dhe gjyqsore ne te gjitha shkallet dhe te cfaredo lloji qofshin ato,, te kryeje vepime te ndryshme qe konsiderohen te nevojshme per arritjen e qellimeve e shoqerise.

NENI 9

Shoqeria me pergjgjesi te kufizuar "XHENI A.D." shpk Shkoder ka nje administrator ,por kjo nuk pengon qe ne te ardhmen me vendim te ortakut te vetem,numri i tyre te ndryshoje duke u bazuar ne ligj.

NENI 10

Administratori eshte pergjegjes para shoqerise dhe te treteve si per shkeljet ligjore, shkeljet e statutit ose per fajet e kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 11

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje shpk "XHENI A.D."

Te drejten e perdorimit te vuls e ka krijuesi i shqoerise,ortaku i saj i vetem Zj.Arjana Demi.si dhe administratori i emeruar nga ortaku i vetem, apo personat e autorizuar prej tij.

MERDHENIET E PUNESIMIT

NENI 12

Mardheniet e punes rregullohen nga kontrata e punes qe lidhen midis perfaqsuesit te shoqerise dhe personit te punesuar ne kete shoqeri.Mosmarveshjet ndermjet paleve zgjidhen me mirkuptim, ne rast te kundert i drejtohen organit kompetent te percaktuar ne kontraten e punes.

NENI 13

Ortaku i vetem percakton administratorin dhe punonjesit e tjere te cileve u cakton pagat dhe detyrat.
Shoqeria respekton rreglat e punesimit dhe te sigurimeve shoqerore, kurse te punesuarit jane te detyruar te pranojne dhe zbatojne normat e ketij statuti.Administratori i emeruar nuk mund te marre cilesine e ortakut te vetem te shoqerise dhe as te zhvilloje aktivitet kontraktor te cfaredo lloji per llogari te tij.

NENI 14

Te gjithe te punesuarit ne kete shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se shoqerise gjate dhe ne rastet e largimit nga puna. Sekret pune paraqesin shkresat materiale, si dhe aktet te cilat me ligj me dispozita te vecanta apo me vendime te ortakut te vetem

te shoqerise, jane shpallur sekret pune, te dhenat informative, bilancet, planet dhe iformacionet per politiken ekonomike te shoqerise qe u jepen organeve kompetente perkatese te miratuara nga ortaku i vetem i shoqerise.

PERFAQSIMI I SHOQERISE

NENI 15

Perfaqsimi i shoqerise "XHENI A.D." shpk Shkoder i perket ortakut t vetem te saj dhe administratorit te autorizuar prej tij. Ai ka te drejte te perfaqsoje shoqerine edhe ne organet gjyqsore dhe ne gjykime, te caktoje dhe te pushoje avokate per ceshtje ne gjykim.

E gjithe veprimtaria ekonomike e shoqerise drejtohet nga ortaku i vetem i saj Zj.Arjana Demi, e cila vendos per pjesmarrjen e shoqerise ne shoqerite e tjera, te ndryshoje ose te plotesoje statutin e shoqerise, te miratoje bilancet vjetore dhe periodike te vleresuara nga organi i saj financiar, te vendose per shperberjen e shoqerise, te percaktoje politiken ekonomike ne fushat e zhvillimit t veprimtarise se saj.

EKSPERTI KONTABEL

NENI 16

Ortaku i vetem Zj,Arjana Demi mund te caktoje edhe ekspert kotabel, te cilet kontrollojne veprimtarine financiare, arken e regjiostrin e veprimeve kotabel dhe t pergatisin raportin perkates se shoqerise.

BILANCI DHE TE ARDHURTA

NENI 17

Shoqeria "XHENI A.D." shpk Shkoder, cel llogarine e saj rrjedhense ne Banka Shqiptare. Veprimet ekonomike te shoqerise mbyllen mme 31 dhjetor. Ne fund te cdo periuhe nxirret bilanci kontabel prej ekspertit kontabel, qe miratohet nga ortaku i vetem i shoqerise .

Te ardhurat neto, pas cvecimnit te fondeve te nevojshme i mbeten ortakut te vetem te shoqerise e cila ndahet per zgjerimin e kapitalit te shoqerise, se dyti per fondet e shoqerise dhe se treti per ortakun e vetem.

FONDET E SHOQERISE

NENI 18

Shoqeria percakton fondet si me poshte:

a-fondin themeltar

b-fondi rezerve

c-fonde te tjera te cilat mund te jene te nevojshme per realizimin e veprimtarise se saj.

Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij percaktohen nga ortaku i vetem i shoqerise.

CMIMET

NENI 19

Aktivitetin e saj shoqeria "XHENI A.D" shpk Shkoder e zhvillon kundrejt cmimeve sipas kerkeses dhe ofertes, me perjashtim te rasteve te percaktuara me vendim qeverie.

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 20

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, siper humbje te kapitralit te shoqerise, pamundesi veprimtarie me vendim me shkrim te ortakut te vetem te shoqerise.

NENI 21

Me shperberjen e shoqerise caktohen nje ose disa likujdatore , duke iu caktuar edhe detyra konkrete, ne radhe te pare per likujdimin e personave te trete duke percaktuar edhe burimet likujdimit.

NENI 22

Persa nuk eshte shprehur ne statut i referohet plotesimeve qe do te bje ortaku i vetem i shoqerise ne baze te ligjeve ekzistuese e te ligjeve e akteve nenligjore qe do te dalin.

(6) Të regjistrohet kërkesa
Kërkuese më 26.09.2001
Gjyqtare Z. Sollaku
[signature]

# K E R K E S E

Z. Z. Sollaku
25.09.2001
[signature]

25 SET 2001

KERKUSE:ARJANA DEMI e bija e Teki e dtl 1960 banuese ne Shkoder L.Perlat Rexhepi, rruga Bardhok Biba nr.9.

26362

OBJEKTI: Regjistrimi si person juridik i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "XHENI A.D." shpk Shkoder.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.7512 date 10.8.1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones tregtare e te privatizimit"dhe ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"dhe ligjit nr.7667 dt 28.01.1993, "Per regjistrimin e s[...] tregtar"

PERPARA : Gjykates s[...]ethit gjyqsor TIRANE

Ne baze te ligjit nr.7512 date 10.8.1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones tregtare e te privatizimit"dhe ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"dhe ligjit nr.7667 dt 28.01.1993, "Per regjistrimin e shoqerisve ne regjistrin tregtar", i kerkoj kesaj Gjykate te beje regjistrimi si person juridik te shoqerise me prgjegjesi te kufizuar "XHENI A.D." shpk Shkoder ne emer te Zjk.Arjana Demi.

Kjo shoqeri do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e:

-tregtimit me shumice e pakice te mallrave te ndryshem te import-eksportit,artikujve te ndryshem industrial,te konsumit te gjere,ushqimore , bujqesor e blegtoral,elektroshtepiake ,makineri e paisje ,materiale ndertimi ,eksport-importit,
-transport mallrash e pasagjeresh,
-te perfaqsimit te firmave te ndryshme te huaja,ndermjetesimit me te gjitha llojet per tregtine me jashte dhe pune komisionere ne fushen e tregtise,
-ne fushen e telekomunikacionit.
Afati i kesaj shoqrie do te jete mbi 10 vjete,<Kapitali i saj themeltar eshte 100.000 leke. Ajo do te ushtroje aktivitetin e saj brenda dhe jashte vendit dhe seklia e saj do te jete Qyteti Shkoder, sheshi "2 Prilli".

— Mandat arkëtimi B. Kursimeve
nr. 0510372 dt. 18.08.2001
[signature]

KERKUESE

ARJANA DEMI

Arjana Demi
[signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE SHKODER

NR REP 1372
NR KOL 681

## AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Sot me dt 22.09.2001 ne zyren e noterise Shkoder dhe para meje noteres Anila Dibra u paraqit personalisht Zj.Arjana Demi e bija e Teki e dtl 1960 banuese ne Shkoder ,per identitetin e te ciles u sigurova ne baze te dokumenteve te saj te identifikimit dhe pasi konstatova se i ka te gjitha aftesite e kerkuara nga ligji dhe me deshiren e saj te plote i vertetova nenshkrimin.

NOTERE:ANILA DIBRA